

VENDIM
Nr. 215, datë 11.10.2018

**MBI TRANSFERIMIN E LICENCËS SË FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE
ME NR. 251, ME SERI P14FPP, MIRATUAR ME VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s
NR. 97, DATË 27.10.2014, E VLEFSHME DERI NË DATËN 27.10.2019, DHE TË
DETYRIMIT TË SHËRBIMIT UNIVERSAL TË FURNIZIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE, TË SHOQËRISË “OPERATORI I SHPËRNDARJES SË ENERGJISË
ELEKTRIKE” SHA (OSHEE SHA), MIRATUAR ME VENDIMIN E BORDIT TË ERE-
s NR. 112, DATË 8.7.2016, TE SHOQËRIA “FURNIZUESI I SHËRBIMIT UNIVERSAL”
SHA
(FSHU SHA)**

Në mbështetje të nenit 16; të nenit 19, germa “d”; të nenit 37, pika 2, germa “ç” dhe të nenit 44, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 2 dhe të nenit 4, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 244, datë 30.3.2016, të ndryshuar, “Kushtet për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”; të nenit 4, pika 1, germa “c”; të nenit 5, pika 1, germa “c”; të nenit 13; të nenit 17, pikat 1, 2, 4 dhe 5, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, si dhe të nenit 15, të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 11.10.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga drejtoritë teknike të ERE-s, mbi transferimin e licencës së furnizimit energjisë elektrike me nr. 251, seria P14FPP, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 97, datë 27.10.2014 dhe detyrimit të shërbimit universal të furnizimit të energjisë elektrike, të shoqërisë “Operatori i shpërndarjes së energjisë elektrike” sh.a. (OSHEE sh.a.), miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 112, datë 8.7.2016, te shoqëria “Furnizuesi i shërbimit universal” sh.a. (FSHU sh.a.),

konstatoi se:

- Shoqëria OSHEE sh.a., me shkresën nr. 7818 prot., datë 27.4.2018, ka përcjellë në ERE dokumentacionin për transferimin e licencave/ licencimin e shoqërive të kontrolluara nga OSHEE sh.a.

- Me shkresën nr. 2 prot., datë 27.4.2018, “Furnizuesi i shërbimit universal” sh.a. (FSHU sh.a.) ka paraqitur në ERE kërkesën për transferimin e licencës së furnizimit të energjisë elektrike nga shoqëria OSHEE sh.a. te shoqëria “Furnizuesi i shërbimit universal” sh.a. (FSHU sh.a.).

- Shoqëria “Furnizuesi i shërbimit universal” sh.a. (FSHU sh.a.) është themeluar me statusin e shoqërisë aksionare në zbatim të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar dhe të urdhrit të Asamblesë së Përgjithshme nr. 157 prot., datë 12.2.2018, të shoqërisë OSHEE sh.a., në cilësinë e aksionarit themelues. Data e themelimit është 28.3.2018.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 122, datë 4.6.2018, vendosi të fillojë procedurën për transferimin e licencës së furnizimit të shërbimit universal të energjisë elektrike, të shoqërisë “Operatori i shpërndarjes së energjisë elektrike” sh.a. (OSHEE sh.a.), miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 97, datë 27.10.2014, e vlefshme deri në datën 27.10.2019, te shoqëria “Furnizuesi i shërbimit universal” sh.a. (FSHU sh.a.).

- Pas vendimmarrjes së sipërcituar, ERE, në zbatim të nenit 10, pikat 8 dhe 9, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në

sektorin e energjisë elektrike”, me shkresën nr. 55/36 prot., datë 13.6.2018, bëri njoftimin në median e shkruar lidhur me kërkesën e bërë nga ky subjekt.

- Në përfundim të afatit të parashikuar në nenin 10, pika 11, të rregullores së sipërcituar, nuk rezultoi të ketë ndonjë vërejtje apo ankesë nga palët e treta, lidhur me këtë aplikim.

- Shoqëria OSHEE sh.a. është licencuar në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike me pakicë, me vendimin nr. 97, datë 27.10.2014, të Bordit të ERE-s, dhe mban licencën me nr. 251, seria P14FPP.

- Me shkresën nr. 7818 prot., datë 27.4.2018, protokolluar në ERE me nr. 355 prot., datë 30.4.2018, “Përcillet dokumentacioni ...”, “Operatori i shpërndarjes së energjisë elektrike” (OSHEE sh.a.), ndër të tjera bën me dije, se: “Transferimi i personelit për këtë shoqëri, “Furnizuesi i shërbimit universal” (FSHU sh.a.) është në proces. Për rrjedhojë, lista e personelit, sipas profilit, në përputhje me aktivitetin për të cilin kërkohet licenca, do të plotësohet në vijim”.

- Me shkresën nr. 355/5 prot., datë 9.8.2018, ERE i ka kërkuar aplikuesit plotësim dokumentacioni dhe me shkresën e datës 3.9.2018, protokolluar me tonën nr. 355/6 prot., “Operatori i shpërndarjes së energjisë elektrike” (OSHEE sh.a.) ka përcjellë në ERE dokumentacionin e munguar për llogari të shoqërisë “Furnizuesi i shërbimit universal” (FSHU sh.a.).

- Aplikimi i shoqërisë FSHU sh.a. plotëson kryesisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, si më poshtë:

- Format i dokumentacionit për aplikim (neni 17, pika 2, germa “a”, formati i aplikimit sipas nenit 9, pika 1, gjerat “a”, “b”, “c”): plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 17, pika 2, germa “b”, dokumentet juridike, administrative dhe pronësore, sipas nenit 9, pika 2, gjerat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”) është plotësuar kryesisht, me përjashtim të listës së personelit, sipas profilit në përputhje me aktivitetin për të cilin kërkohet licenca.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 17, pika 2, germa “c”, dokumentet financiare dhe fiskale, sipas nenit 9, pika 3, gjerat “a”, “b”, “c”, “d”): plotësuar në mënyrë korrekte.

- Neni 17, pika 4, germa “a” (Formati i aplikimit, sipas nenit 9, pika 1): plotësuar në mënyrë korrekte.

- Neni 17, pika 4, germa “b” (Një informacion me shkrim ku të shpjegohen arsyet e kërkesës për transferimin e licencës): plotësuar në mënyrë korrekte.

- Neni 17, pika 4, germa “c” (Vendimin me shkrim të organeve drejtuese të të licencuarit që shprehin vullnetin për të kërkuar transferimin e licencës): plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Transferimin e licencës së Furnizimit të Energjisë Elektrike me nr. 251, seria P14FPP, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 97, datë 27.10.2014, e vlefshme deri në datën 27.10.2019, dhe të detyrimit të shërbimit universal të furnizimit të energjisë elektrike, të shoqërisë “Operatori i shpërndarjes së energjisë elektrike” sh.a. (OSHEE sh.a.), miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 112, datë 8.7.2016, të shoqëria “Furnizuesi i shërbimit universal” sh.a. (FSHU sh.a.).

2. Shoqëria “Furnizuesi i shërbimit universal” sh.a. (FSHU sh.a.) të paraqesë në ERE listën e personelit, sipas profilit, në përputhje me aktivitetin për të cilin kërkohet licenca, pasi të përfundojë transferimi i personelit për këtë shoqëri, “Furnizuesi i shërbimit universal” sh.a. (FSHU sh.a.), nga struktura përkatëse.

3. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti